

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“HIDROCENTRALI CANGONJ” sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare’ dhe atij nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin tone te lire, ne:

- 1. “FAVINA 1”sh.p.k. me numer NIPT K54624001I ,**
- perfaqshuar nga administratori i saj zoti Viktor Qylafi i biri i Fatmir shtetas shqiptar, lindur me 03.02.1963 ne Korce dhe banues ne Melcan , Korce, me leter njoftim nr. BD4632 689 dhe

- 2. FAVINA sh.p.k. me numer NIPT J64104078V ,**
- perfaqshuar nga administratori i saj zoti Viktor Qylafi i biri i Fatmir shtetas shqiptar, lindur me 03.02.1963 ne Korce dhe banues ne Melcan , Korce, me leter njoftim nr. BD4632 689.

Te dy shtetas madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , shpallim si vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar **“HIDROCENTRALI CANGONJ” sh.p.k** me ortake themelues shoqeria FAVINA 1 sh.p.k dhe shoqeria FAVINA sh.p.k. me gjeneralitet e mesiperme.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themelueseve te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne CANGONJ ne **“HIDROCENTRALI CANGONJ”** ne KOMUNA POJAN,RRETHI KORCE, QARKU KORÇE. Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise e saj ne perputhje me afatin e Kontrates se Koncesionit Nr. 5838 Rep. Nr.1707 Kol. date 20/05/2013 me nje afat 35 vjet.

NENI 5

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushen e

Ndertimi, Operimi dhe Transferimi i hidrocentralit "CANGONJ", tek Autoriteti Kontraktues, ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, sipas kontrates koncensionare BOT me Nr. 5838 Rep. Nr.1707 Kol. date 20/05/2013 e lidhur midis METE (Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes) dhe Bashkimit te Perkohshem te shoqerive FAVINA 1 sh.p.k. dhe FAVINA sh.p.k

Ortaket e shoqerise bien dakort qe aktivitetet e mesiperme do te fillojne pasi shoqeria te pajiset me licencat perkatese.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 70.000.000 (shtatedhjetmilion) leke dhe perbehet nga 100 kuota me vlefte nominale 700.000 leke secila, me kontributet e ortakeve si me poshte:

1. **"FAVINA 1" sh.p.k.** 35.700.000 leke, 51 kuota ose 51% te kapitalit , numri i votave 51.
2. **"FAVINA" sh.p.k.** 34.300.000 leke, 49 kuota ose 49% te kapitalit , numri i votave 49.

Kapitali themeltar do te shlyhet brenda afatit te perfundimit te ndertimit te vepres. Burimi kryesor do te jete kredia bankare qe do merret per kete qellim dhe mjetet e lira te kompanise.

Ndryshimet e kuotave mund te arrihen nepermjet kontributeve ne kapitalin e shoqerise ose me shitblerje.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund të shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave tek të tretët do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve.

NENI 9

Shoqëria ka vullen e saj.

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori

Fusha e veprimit, përberja dhe menyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administratori i shoqërisë "**HIDROCENTRALI CANGONJ**" sh.p.k emërohet z. Adnan Qylafi me afat 5 vjet.

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim të ortakëve, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore.

NENI 14

Ky akt u përpilua në prani të ortakut duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Akti u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Korce e për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

Korce më 30.05.2013

ORTAKËT THEMELUES

"FAVINA 1" sh.p.k.

